



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr._____, datë_____

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN
E MARRËVESHJES SË PRANIMIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR
NGA KRYEMINISTRI EDI RAMA, NË KARTËN E BORDIT
TË PAQES”**

Në mbështetje të neneve 81, 83, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për ratifikimin marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Paqes”, për shqyrtim e miratim, me procedurë të përshpejtuar, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

ELISA SPIROPALI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr.____/2026

PËR

**RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË PRANIMIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KRYEMINISTRI EDI RAMA,
NË KARTËN E BORDIT TË PAQES**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pikat 1 dhe 2, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e marrëveshjes së pranimi të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryeministri Edi Rama, në Kartën e Bordit të Paqes, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI